



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government




Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal  
Affairs

Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike / Odbor Kosovske Akademije za Javnu  
Bezbednost / Board of Kosovo Academy for Public Safety

---

# RAPORTI VJETOR 2013



Vushtrri, 2014

## Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
1. Hyrje .....	3
2. Themelimi i Bordit .....	4
3. Aktivitetet kryesore të Bordit .....	5
3.1. Standardet minimale profesionale .....	6
3.2. Politikat për trajnimin në fushën e sigurisë publike .....	6
3.3. Politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar .....	8
3.4. Shqyrtimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Akademisë .....	9
4. Përfundimi .....	10

## 1. HYRJE

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Me qëllim të arritjes së objektivave të Akademisë dhe akordimit të politikave që kanë të bëjnë me trajnimet në fushën e sigurisë publike për Institucionet e Sigurisë Publike është paraparë edhe themelimi i Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Si i tillë Bordi ligjërish ka qenë i paraparë edhe me herët që nga viti 2008 me kornizën ligjore të UNMIK-ut, respektivisht Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/18 për themelimin e bordit kosovar mbi standardet e sigurisë publike dhe arsimin, por që asnjëherë nuk është funksionalizuar dhe nuk ka vepruar.

Po ashtu në bazë të Ligjit nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, është paraparë Bordi i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike si autoritet për vendosjen e minimumit bazë të standardeve profesionale, politikave që kanë të bëjnë me trajnimet në fushën e sigurisë publike, edukimin e specializuar dhe të avancuar të Institucioneve për siguri publike në Akademi.

Duke u bazuar në atë se funksionalizimi i Bordit është i një rëndësie të veçantë, marrë parasysh përbërjen, vendosjen e politikave të përbashkëta në trajnimin e zyrtarëve të institucioneve të sigurisë publike, me datë 08 prill 2013 u bë edhe funksionalizimi i tij.

Ky funksionalizim i Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike u bë, pas kompletimit të bazës ligjore dhe falë angazhimit të madh të Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë dhe udhëheqësve të institucioneve të sigurisë.

Funksionimi, përbërja, përgjegjësitë si dhe rregullat e punës së Bordit janë të përcaktuara në bazë të Rregullores nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Në Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike shqyrtohen, analizohen dhe vendosen çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të zyrtarëve të sigurisë publike, gjë e cila është shumë e rëndësishme si për institucionet pjesëmarrëse në Bord po ashtu edhe për tërë Shtetin e Republikës së Kosovës.

## 2. THEMELIMI I BORDIT

Themelimi i Bordit është bërë duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Me qëllim të vendosjes së minimumit bazë të standardeve profesionale, politikave që kanë të bëjnë me trajnimet në fushën e sigurisë publike, edukimin e specializuar dhe të avancuar të Institucioneve për siguri publike në Akademi, është përgjegjësi e Bordit dhe si i tillë funksionalizimi ka qenë një ndër prioritetet e Akademisë me qëllim të përmbushjes së fushëveprimit të tij.

Takimi i parë konstituiv i Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike u bë me datën 08 Prill 2013 në të cilin takim është bërë funksionalizimi i tij.

Bazuar në Rregulloren nr. 06/2013 për Bordin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike përbërja e tij është si vijon:

1. Kryeprokurori i Shtetit - anëtar;
2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës - anëtar;
3. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës - anëtar;
4. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës - anëtar;
5. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës - anëtare;
6. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave - anëtar;
7. Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës - anëtar;
8. Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike - anëtar pa të drejtë vote.

Kryesuesi i Bordit zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve me të drejtë vote për një periudhë prej një viti. Zgjedhjet do të mbahen në takimin e parë të Bordit në fillim të çdo viti kalendarik. Gjatë mbledhjes konstituive të Bordit të AKSP-së me votat e anëtarëve të Bordit u zgjodh kryesuesi i Bordit z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit.

Po ashtu në këtë mbledhje janë vendosur edhe shumë çështje tjera të rëndësishme si orari i mbledhjeve të rregullta të Bordit, plani i punës, caktimi i sekretarisë së Bordit etj.

Gjatë vitit 2013 Bordi i Akademisë e Kosovës për Siguri Publike, bazuar në planin e punës dhe kërkesat e Institucioneve të Sigurisë Publike ka mbajtur pesë takime (katër takime të rregullta dhe një i jashtëzakonshëm).

Në takimet e Bordit përveç anëtarëve dhe Sekretarisë, kanë marrë pjesë edhe mysafirë, zyrtarë, përfaqësues nga Ambasada Amerikane, ICITAP-i, OSBE-ja dhe Ekspertët e Projektit të Binjakëzimit.

### 3. AKTIVITETET KRYESORE TË BORDIT

Bordi me fillimin e punës së tij ka miratuar planin vjetor të punës, qëllimi i së cilës ka qenë përcaktimi i hapave kryesor të cilët i ndërmerr Bordi gjatë vitit 2013 me qëllim të kryerjes së përgjegjësisë të veta në mënyrë që nëpërmes vendosjes së standardeve dhe politikave të trajnimit dhe edukimit, pjesëtarët e institucioneve të sigurisë publike të jenë sa më të përgatitur në mënyrë profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtare të pranuar, në mënyrë që t'u bëjnë ballë të gjitha sfidave në fushën e sigurisë publike.

Në këtë plan të punës janë paraqitur prioritetet e punës së Bordit dhe jep përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara për realizimin e synimeve të cilat janë në funksion të zbatimit të Ligjit të Akademisë.

Aktivitete kryesore janë njëkohësisht edhe detyra dhe përgjegjësi të Bordit si në vijim:

- 3.1. Standardet minimale profesionale;
- 3.2. Politikat për trajnimin në fushën e sigurisë publike;
- 3.3. Politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar, dhe
- 3.4. Shqyrton raportet periodike dhe vjetore.

### 3.1. STANDARDET MINIMALE PROFESIONALE

Bordi me qëllim që të vendos standardet minimale profesionale në përputhje me të gjitha udhëzimet e zbatueshme të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me aftësitë dhe atributet e nevojshme për të kryer funksionet esenciale të pjesëtarit të sigurisë publike e që duhet të respektohen nga të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike, ka vendosur për themelimin e një grupi punues për rishikimin e standardeve dhe programeve të trajnimeve bazike të cilat ekzistojnë me qëllim të zhvillimit, harmonizimit dhe vendosjes së standardeve minimale profesionale.

Bordi në përmbushjen e këtij objekti për vitin 2013 sipas planit të punës, në takimin e tretë të mbajtur me datën 16.09.2013 ka themeluar Grupin Punues për rishikimin e standardeve minimale profesionale dhe programeve të trajnimeve bazike të Institucioneve të Sigurisë Publike në AKSP në përbërje të cilit janë anëtarë nga Akademia dhe gjashtë Institucionet e Sigurisë Publike siç janë: PK-ja, DK-ja, AME-ja, IPK-ja, SHKK-ja dhe SHSK-ja, ndërsa në cilësinë e ekspertëve / vëzhguesve janë përfaqësuesit nga ICITAP-i dhe nga OSBE-ja.

Qëllimi i themelimit të Grupit punues për rishikimin e këtyre standardeve dhe programeve është që këto standarde dhe programe të validohen nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve si organ kompetent për validimin e standardeve të profesioneve dhe programeve mësimore, gjë e cila Akademinë e ngrit edhe në një shkallë më të lartë drejt ofrimit të programeve të trajnimeve të akredituara në fushën e sigurisë publike.

Po ashtu Bordi ka shqyrtuar Raportin e punës së këtij Grupi punues dhe ka inkurajuar që të vazhdohet puna në kryerjen e detyrave të përcaktuar nga Bordi dhe të finalizohen për takimet e radhës.

### 3.2. POLITIKAT PËR TRAJNIMIN NË FUSHËN E SIGURISË PUBLIKE

Bordi i AKSP-së vendos politikat për trajnimin në fushën e sigurisë publike me qëllim të përcaktimit të programeve të trajnimeve për kryerjen e detyrave nga ana e pjesëtarëve të sigurisë publike.

Në lidhje me këtë nga ana e Bordit është bërë edhe:

- Shqyrtimi i projekt Planit të trajnimeve të Akademisë për vitin 2014

Në takimin e pestë të Bordit është shqyrtuar projekt Plani i trajnimeve për vitin 2014. Për finalizimin e këtij projekt Plani të trajnimeve për vitin 2014 Akademia ka formuar grupin punues me përfaqësuesit e të gjitha Institucioneve të Sigurisë Publike.

Andaj Bordi me qëllim që të bëhet një plan i trajnimeve edhe me i suksesshëm ka rekomanduar që në fazën finale institucionet e sigurisë publike të dërgojnë përfaqësuesit e tyre të zgjedhur që të japin kontribut të veçantë në mënyrë që të kemi një plan përfundimtar të trajnimeve për vitin 2014 i cili do t'i plotësojë nevojat e secilit institucion që është i përfaqësuar në Bord.

- Krijimi i sistemit të trajnimeve të përbashkëta për institucionet e sigurisë publike

Bordi ka paraqit idenë për krijimin e sistemit për trajnime të përbashkëta të institucioneve të sigurisë publike. Qëllimi i diskutimit ka qenë që për ato trajnime ku ekziston mundësia teorike dhe praktike apo fushat e përbashkëta të mbahen bashkërisht, me qëllim të zvogëlimit të shpenzimeve dhe që trajnimet të kenë efektin e tyre edhe më të madh.

Krijimi i sistemit të trajnimeve të përbashkëta shihet si politikë e trajnimeve pasi që në këto trajnime shqyrtohen edhe rastet praktike dhe trajnimet janë shumë më interaktive dhe kjo ndikon edhe në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit, dhe po ashtu zyrtarët mund të këmbejnë mendimet lidhur me çështje të rëndësishme për kryerjen e detyrave të punës së tyre.

Gjithashtu Bordi i inkurajoj institucionet që të japin kontributin e tyre dhe propozimet se në cilën lëmi dhe me cilin Institucion duhet të jenë trajnimet e përbashkëta.

- Shqyrtimi i Projekt Strategjisë Zhvillimore të AKSP-së (2014-2018)

Projekt Strategjia Zhvillimore e AKSP-së për vitet 2014-2018 u vlerësua lartë për arsye se me plan të veprimit janë përcaktuar qartë aktivitetet, afatet dhe akterët për zbatimin e saj.

Arritja e objektivave, implementimi dhe zbatimi i strategjisë zhvillimore të Akademisë është në interes të të gjitha Institucioneve të Sigurisë Publike dhe si e tillë është përkrahur nga ana e Bordit.

### 3.3. POLITIKAT PËR EDUKIMIN E SPECIALIZUAR DHE TË AVANCUAR

Bordi i AKSP-së vendos politikat për edukimin e specializuar dhe të avancuar duke i identifikuar fushat në të cilat edukimi i tillë është i nevojshëm.

- Miratimi i kërkesës për vendosjen e Institutit të Kosovës Kundër Krimeve Ekonomike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

Bordi në mbledhjen e tretë ka miratuar kërkesën për vendosjen e Institutit të Kosovës Kundër Krimeve Ekonomike” në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Vendosja e këtij Instituti në Akademi u vlerësua si shumë e rëndësishëm. Përmes programeve trajnuese të cilat i ofron ky institut mundësohet ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtareve të sigurisë publike për luftimin e dukurive negative duke parandaluar, zbuluar, hetuar dhe mbështetur ndjekjet penale nga sfera ekonomike si: pastrimi i parasë, financimi i terrorizmit, evazioni fiskal dhe korrupsioni si dhe konfiskimin e te ardhurave kriminale.

- Marrëveshja e bashkëpunimit me Institucionet e Sigurisë Publike

Akademia me qëllim të rritjes së bashkëpunimit me Institucionet e Sigurisë Publike për realizimin e objektivave ka nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimi me të gjitha Institucionet e përfaqësuara në Bord. Me këto marrëveshje janë përcaktuar dy fusha të bashkëpunimit si prioritet: angazhimi i personelit në ligjërimitin e lëndëve profesionale në Akademi dhe në avancimin e planeve dhe programeve arsimore si dhe krijimi i rrjetit të mentorëve të periudhës praktike në vend pune.

Ngritja e nivelit të personelit profesional në Akademi ndikon edhe në ngritjen e cilësisë dhe efikasitetit.

- Miratimi i Deklaratës për aprovimin e kurrikulës së studimeve në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Gjatë mbledhjes së katërt, anëtarët e Bordit vendosen për miratimin e Deklaratës për aprovimin e kurrikulës së studimeve në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në të cilën deklarata shprehimisht jepet qartë pranueshmëria e programit të studimeve të nivelit Bachelor në Fakultetin e Sigurisë Publike në Akademi. Ky program studimi është punuar nga ekspertët e Projektit të Binjakëzimit (zbatuesit të projektit nga Finlanda dhe Estonia) në bashkëpunim edhe të personelit të përzgjedhur nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe Institucionet e



Sigurisë Publike siç janë: Policia e Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, Shërbimi korrektues i Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Me këtë program studimor të pranueshëm do të arrihen kompetencat e nevojshme për të punësuarit në institucionet e sigurisë publike në Republikën e Kosovës.

- Miratimi i kuotave për institucioneve e sigurisë publike lidhur me vendet e studimit në studimet themelore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

Bordi ka pasur një rol të rëndësishëm në harmonizimin e kërkesave për caktimin e kuotave të studentëve dhe për numrin e përgjithshëm të studentëve që do të studiojnë në Akademi në vitin e parë të studimeve. Duke u bazuar në nevojat dhe numrin e zyrtareve të punësuar në këto Institucione të Sigurisë janë përcaktuar kuotat e institucioneve të sigurisë publike dhe numri i përgjithshëm i studenteve për vitin akademik 2014-2015.

### 3.4. SHQYRTIMI I RAPORTEVE PERIODIKE DHE VJETORE

- Shqyrtimi i Raportit gjashtë mujor (janar – qershor 2013) të punës së Akademisë së Kosovës për Siguri Publike

Me qëllim të pasqyrit të punës së Akademisë ,Bordi në mbledhjen e tretë ka shqyrtuar Raportin gjashtë mujor (janar – qershor) të punës së Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për vitin 2013 . Pas analizimit, shqyrtimit dhe rekomandimeve të dhëna ka miratuar Raportin gjashtë mujor (janar – qershor) të punës së Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për vitin 2013

- Shqyrtimi i planit të punës së Institutit të Kosovës Kundër Krimeve Ekonomike

Në kuadër të shqyrtimi të planit të punës së këtij Instituti theks të veçantë Bordi i ka kushtuar analizave të nevojave të trajnimit, krijimi i orarit të trajnimeve për vitin 2014 si dhe krijimi i manualit të përgjithshëm i cili paraqet pikat e udhëheqjes së hetimeve të krimeve ekonomike.

Anëtarët e Bordit aprovuan planin e punës së këtij Instituti dhe kanë vlerësuar të arriturat e tij. Bordi gjithashtu ka rekomanduar lidhur me trajnimet e ofruara nga ky Instituti se trajnimet duhet të jenë të përbashkëta për të gjitha organet që zbatojnë ligjet me qëllim të krijimit të një

praktikë ekonomike duke inkuadruar edhe : Policinë, Administratën Tatimore, prokurorët dhe gjyqtarët.

## 4. PËRFUNDIMI

Funksionalizimi i Bordit ka reflektuar shume në avancimin, zhvillimin dhe forcimin e punës profesionale të zyrtarëve të sigurisë publike e në veçanti në implementimin e Ligjit të Akademisë.

Takimet e Bordit dhe vendimet që janë marrë në kuadër të përgjegjësive të veta ligjore gjatë periudhës raportuese kanë dhënë rezultate dhe kanë qenë shumë të frytshme për Institucionet e Sigurisë Publike me qëllim të avancimit të politikave efektive dhe të koordinuara.

Bordi përmes këtij raporti të punës pasqyron përmbledhjen e aktiviteteve të kryera dhe të ndërmarra të cilat janë paraqitur sipas fushave që mbulon për periudhën raportuese dhe realizimin e shumicës së objektivave të përcaktuara në planin e punës për vitin 2013.

Duke marrë parasysh sfidat e Institucioneve të Sigurisë Publike dhe Akademisë me të cilat duhet ballafaquar, kryerjen e përgjegjësive në mënyrë profesionale nga zyrtarët e sigurisë publike në përballimin e nevojave të sigurisë në vend, do të jenë prioritete të Bordit edhe në të ardhmen, me synimin që të kontribuojmë në arritjen e standardeve më të larta të sigurisë dhe rendit publik në të mirë të institucioneve, shoqërisë e në përgjithësi të shtetit.

Andaj në fund të këtij raporti mund të themi me bindje të thellë se do të përkushtohemi në identifikimin e mekanizmave, krijimin e politikave të mirëfillta trajnuese të cilat do ndikojnë në rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit tek Institucionet e Sigurisë Publike dhe realizimin e objektivave të përcaktuara.